



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

Lënda: Njoftim për 1(një) vend të lirë pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në Rektoratin e Universitetit të Tiranës

Drejtuar: **Znj. Reida Kashta**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik**

Rektorati i Universitetit të Tiranës shpall konkursin për **1(një) vend të lirë pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ, të emërtesës “Specialist” në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme.**

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë këto **kritere të përgjithshme:**

1. Të jenë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;
2. Të zotërojnë diplomën "Master i Shkencave" ose diplomë ekuivalente me të, preferohet në Ekonomi ose në Drejtësi.
3. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale me dashje;
4. Të mos jetë marrë ndaj tij masa disiplinore e largimit nga puna.

Kandidatët konkurrentë për këtë vend pune, duhet të plotësojnë edhe këto **kritere të veçanta:**

1. Të njohë Kodin e Punës në RSH, ligjin e arsimit të lartë, si edhe legjislacionin në përgjithësi që rregullojnë marrëdhëniet e punës në institucionet e administratës shtetërore.
2. Të njohë me dëshmi një gjuhë të huaj, preferohet gjuha angleze, e provuar me dëshmi;
3. Të kenë njohuri shumë të mira në përdorimin e kompjuterit, të provuara me dëshmi;
4. Të ketë aftësi të mira komunikuese, etike profesionale dhe të punës në grup.
5. Preferohet të ketë eksperiencë pune deri në 1 vit në këtë pozicion ose në pozicione pune të ngjashme.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim;
2. Curriculum vitae;
3. Diplomë e studimeve universitare dhe lista e notave (fotokopje e noterizuar). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopja e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga institucioni përgjegjës;
4. Të paktën dy referenca nga punëdhënësit e mëparshëm;

5. Dëshmi penaliteti;
6. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (fotokopje e noterizuar);
7. Dëshmi që të vërtetojë njohuritë e përdorimit të kompjuterit (fotokopje e noterizuar);
8. Kopje të librezës së punës (fotokopje e noterizuar);
9. Raport mjekësor për aftësinë në punë.

Dokumentat pranohen në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, nga data **31.01.2022** - **14.02.2022**. Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

**REKTORI**

**Prof. Dr. Artan Hoxha**